



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 121 dt.28.04.1994

PER
RRITJEN E PAGAVE TE KESHILLAVE DREJTUESE
TE NDERMARRJEVE LOKALE TE INDUSTRISE

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.28.04.1994, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Seksioni i Prognozës “Për rritjen e pagave të Këshillave Drejtues të Ndërmarrjeve Lokale të Industrisë”, në zbatim të vendimit të K.M.Nr.623, dt.31.12.1993, mbështetur në kopetencat që i jep këtij Këshilli Ligji “Për Ndërmarrjet Shtetërore”, Nr.7582, dt.13.07.1992, neni.19, pika.5 dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.14, pika.10

VENDOSI

1. Aprovimin e pagave të mëposhtëme

1.Dega Mekanike

1.Për Fonderitë e Uzinës Mekanike “Tirana”

– Paga e drejtorit dhe Këshillit Drejtues të Ndërmarrjes të jetë 7.200 lekë.

2.Uzina Elektro Mjeksore

– Paga e drejtorit të jetë 7.000 lekë në muaj.

3.Uzina Mekanike Bujqësore

– Paga e drejtorit të jetë 6.000 lekë në muaj.

4.Ndërmarrja Elektroteknike

– Paga e drejtorit të jetë 7.500 lekë në muaj.

Kjo pagë të jetë në këtë nivel sepse është ndërmarrje që punon me lëndën e pagë të porositësit.

2.Dega Artistike e artizanatit

1.Ndërmarrja e larjes sixhadeve

– Paga e drejtorit të jetë 6.000 lekë në muaj.

2.Ndërmarrja e enëve të bakrit

– Paga e drejtorit të jetë 6.500 lekë në muaj.

3.Ndërmarrja e prodhimeve Argjendi

– Paga e drejtorit të jetë 6.500 lekë në muaj.

4.Ndërmarrja e Prodhimit të qëndisjeve “ARTIR”

– Paga e drejtorit të jetë 6.500 lekë në muaj.

5.Ndërmarrja Artistike dru ulliri

– Paga e drejtorit të jetë 6.500 lekë në muaj.

3.Dega Minierave

1.Fabrikë e pasurimit të graniteve

– Paga e drejtorit është 6.500 lekë në muaj

4.Dega Kimi – Qelq

1.Ndërmarrja e Prodhimit të bojrave të vajit

– Paga e drejtorit të jetë 7.000 lekë në muaj.

5.Dega e Drurit

1.Ndërmarrja e Amballazheve të kartonit

– Paga e drejtorit të jetë 7.000 lekë në muaj.

2.Ndërmarrja e prodhimit të Amballazh – proto

– Paga e drejtorit të jetë 7.500 lekë në muaj.

Kjo pagë të jetë në këtë nivel pasi është ndërmarrje punon me lëndën e parë të porositësit.

3.Ndërmarrja e prodhimit të Furçë – masure

– Paga e drejtorit të jetë 7.500 lekë në muaj.

Kjo pagë të jetë në këtë nivel sepse është ndërmarrje që punon me lëndëne parë të porositësit.

4.Ndërmarrja e Prodhimeve Prej druri

– Paga e drejtorit të jetë 7.000 lekë në muaj.

5.Ndërmarrja e Shërbimeve Mekanike

– Paga e drejtorit të jetë 6.000 lekë në muaj.

6.Dega Poligrafike

1.Shtypshkronja Çajupi

– Paga e drejtorit të jetë 7.200lekë në muaj.

2.Ndërmarrja e Riparimeve Poligrafike

- Paga e drejtorit të jetë 6.800 lekë në muaj
- 2. Për anëtarët e Këshillit Drejtues të ndërmarrjes, kur e kanë detyrën e Kryetarit të Degës Teknike, apo ekonomike, paga e tyre të jetë 15 përqind më e vogël se e drejtorit, ndërsa për specialistë anëtarë të Këshillit Drejtues, paga e tyre të jetë 20% më e vogël se e drejtorit.
- 3. Në zbatim të Vendimit të K.M. Nr.623, dt.31.12.1993, drejtorit të Ndërmarrjes dhe anëtarët e Këshillit Drejtues përfitojnë rritje mbi pagë (kur plotësojnë kushtet) mbi 5 deri në 50% të njëjtën masë që do të përfitojnë punonjësit e tjerë të ndërmarrjes.
- 4. Këto paga sipas ligjit në fjalë do të zbatohen nga 1 Janari 1994.

KRYETARI

BESNIK PETRELA